



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVA – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT,
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of Minister

Kancelarija Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

NUMËR: 14/2004

DATË: 17.05.2004

LËNDA: ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR KLASËN E SHTATË(VII)

Në bazë të nenit 6.1 paragrafi (b), si dhe nenit 7.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe në përputhje me nenin 1.3 pika(ç) të Rregullores numër 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi degen e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i Planit dhe programit mësimor për klasën e shtatë (VII), si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

Neni 2

Plani dhe programi i ri për klasën e shtatë(VII) i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

3.1. Ky Plan dhe program për klasën e shtatë(VII) zbatohet nga viti shkollor 2004/2005.

3.2. Me zbatimin e Planit dhe të programit të klasës së shtatë(VII) shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së shtatë(VII) të shkollës fillore.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi më nënshkrimin e Ministrit.

Mr. Rexhep Osmani, Ministër